BULETINI INNOVET ALBANIA

Le të kontribuojmë drejt një komuniteti më të fortë të Arsimit dhe Formimit Profesional!

I dashur lexues,
për mua është kënaqësi që të hap buletinin e 11 të gazetës Innovet dhe mbi të gjitha të jap një përshkrim të shkurtër të shkollës të cilën unë drejtoj dhe risitë për sa i përket arsimit profesional në vendin tonë.
Unë jam Erina Disho Drejtore e Shkollës së Mesme Profesionale "Mihal Shahini"Cërrik. Kam studiuar Gjuhë Letërsi dhe zoteroj Master Shkencor në profilin Albanologji Kam një eksperiencë 17 vjeçare në këtë shkollë ,si mësuese dhe si drejjtuese prej vitit 2016. Motoja e cila më shoqëron gjatë gjithë kohës është: ***"Nxënësit janë jo vetëm burimi ku ne dërgojmë dijet por edhe nga ku dijet tona marrin rrugën e suksesit."***

Të punosh me të rinjtë është një nga përgjegjësitë më të mëdha që një i rritur mund të marrë mbi supe sepse orientimi që ne i japim është ai që atyre i hap dyert e jetës. Prandaj punoj çdo ditë me përkushtim dhe me të njëjtin pasion si ditën e parë të punës. Sot, ndryshimi i perceptimit të rëndësisë ndaj arsimit profesional dhe shkollave profesionale vjen si rezultat i punës së një ekipi i cili me profesionalizëm motivon çdo ditë nxënësit që zgjedhin të studiojnë në shkollën tonë.

Shkolla profesionale "Mihal Shahini" ndodhet në qytetin e Cërrikut prej 1968 pra kemi të bëjmë me një shkollë me traditë në fushën e Bujqësisë-zooteknisë- veterinarisë dhe kohët e fundit dhe të teknologjisë së përpunimit të produkteve.
Praktikat profesionale janë orientuesi i shkollës. Ato realizohen jo vetëm në Fermën e shkollës por dhe në biznese të ndryshme të profileve përkatëse.Nxënësit fitojnë kompetenca profesionale të cilat i bëjnë të aftë për tregun e punës dhe plotësimit të kërkesave. Oferta e shkollës është gjithmonë në plotësim të këtyre kërkesave. Futja e teknologjisë dhe inovacionit në kurrikulat e drejtimeve lidhet me zhvillimet dhe hapat e shpejtë me të cilat ecën tregu i punës. Prandaj gjithmonë mësuesit janë në kërkim të zhvillimeve më të fundit të teknologjisë duke i ofruar kështu nxënësve dimensione të reja për implementimin e njohuriveë. Në vitin 2021-2022 futja e inovacionit u përqëndrua në disa aspekte:

- Banka gjenetike e bimeve medicinale dhe aromatike

Në Shtator të këtij viti filluam të implemntojmë një projekt i cili do të synojë krijimin e bankës gjenetike të bimëve medicinale dhe aromatike që sot gjenden dhe kultivohen në të gjithë qarkun e Elbasanit. Gjurmimi dhe dokumentimi i këtyre bimëve bëhet në bashkëpunim me bizneset dhe fermerët që grumbullojnë dhe tregëtojnë bimët medicinale dhe aromatike brenda dhe jashtë vendit. Aktualisht kemi hartuar manualin për llojet e bimëve të gjurmuara që arrijnë rreth 132 lloje. Në këtë manual përshkruhen të gjithë treguesit bilogjikë dhe kurativë të tyre, zonën ku kultivohen dhe vitin e kultivimit. Kjo bankë do të ketë si qëllim jo vetëm studimin e tyre nga nxënësit por do të jetë edhe si pikë referimi për studime të mëvonshme.

- Kirurgjia dhe ndërhyrjet tek kafshët e vogla

Vitin e fundit salla e kirurgjisë veterinare është kthyer jo vetëm në një mjedis mësimdhënie por edhe pune pasi aty janë realizuar nga nxënësit ndërhyrje të thjeshta por edhe të vështira kirurgjikale tek kafshët e vogla. Shpejt kjo sallë do të ofrojë të gjitha shërbimet mjekësore për të gjitha kafshët e shoqërimit.

Në këtë numër:

- **Erina Disho Drejtore e Shkollës së Mesme Profesionale "Mihal Shahini" Cërrik.**
- **Takimi Pranveror- Denis Lushi dhe Lumturie Koka na tregojne eksperiencen e tyre me te rinjte e Bashkive Mat dhe Diber**
- **Anila Nanaj (Bani) - Drejtore e shkollës Teknike Ekonomike Tiranë për përvojën e saj me projektin INTERVET WB**
- **Lëvizshmëria afatshkurtër e nxënësve në Francë dhe Slloveni.**
- **Kelvin Zifla- mbi përvojën e tij gjatë kursit të gjuhës angleze me nxënësit e përzgjedhur për lëvizshmërinë e të mësuarit në vendet e BE-së.**
- **Shoqëruesit e grupeve në Slloveni dhe Francë, Entela Gjyla dhe Klevis Musai ndajnë përvojat e tyre**

PUBLIKIMI ARDHSHEM

- **Përvojat e mësuesve gjatë Job Shadowing, Maltë**
- **Përvojat e nxënësve gjatë lëvizshmërisë për të mësuarit në Milano- Itali dhe Sevilia-Spanjë.**
- **Studentët nga Italia -- Përvojat e tyre gjatë qëndrimit dhe praktikave profesionale në Tiranë, Shqipëri, në kuadër të Erasmus+**
- **"International Leather Line & Conf Expo 2022"**
- **Muaji Botëror i Karrierave- Ditët e Karrierës pranë Bashkive Mat; Dibër; Mirditë; Has.**

©AlbanianSkills

Klientët e shkollës të cilët duan të realizojnë ndërhyrje tek kafshët shtëpiake vijnë në shkollë dhe ia besojnë ndërhyrjet nxënësve dhe mjekut veteriner që ndjek këto ndërhyrje. Shërbime të tilla më vonë do të ofrohen për të gjithë klientët me kosto të ulët.

• Sera e produkteve organike

Në fermën e shkollës janë ngritur dy sera, njëra ku kryhet mbikqyrja për mbirjen e farërave me origjinë të pastër dhe fidanëve si dhe shartimi I fidanëve të perimeve. Serra tjetër po ngrihet fillimisht si laborator për studimin e prodhimeve organike, përshtatjen me kushtet meteorologjike dhe më pas të gjitha prodhimet do të tregetohen në dyqanin e shkollës nëpërmjet markës **"Kopshtaqe"**.

Në të gjitha këto aktivitete pjesa më e madhe e punës realizohet përgjatë praktikave profesionale me grupet e përcaktuara me nxënës të klasave të Drejtimit Bujqësi dhe Veterinari.

Pas kësaj panorame në lidhje me shkollën tonë dhe këtë mori aktivitetesh dhe kërkimesh të qëndrueshme kam bindjen që drejtimi i shkollave të tilla në vendin tonë është vërtet një sfidë.

Në Shqipëri janë 6 shkolla që ofrojnë këto drejtime dhe rrjetëzimi, bashkëpunimi mes tyre duhet të jetë sa me i madh dhe më kompakt në mënyrë që të sigurojmë tëardhmen nëpërmjet inovacionit në Bujqësi, Veterinari dhe Teknologjinë e Përpunimit të Produkteve si një rrugë që siguron zhvillim.

©AlbanianSkills

TAKIMI PRANVEROR- DENIS LUSHI DHE LUMTURIE KOKA NA TREGOJNE EKSPERIENCEN E TYRE ME TE RINJTE E BASHKIVE MAT DHE DIBER

Puna me të rinjtë është e bukur por në të njëjtën kohë plot me sfida. Përgjatë këtij Buletini do të lexojmë dhe artikuj të realizuar nga ekspertë të cilët punojnë në përditshmërinë e tyre me të rinjë në qytetet ku ato jetojnë. Artikujt e mëposhtëm do të njohim në mënyrë më specifike me Denis Lushin ekspert i sipërmarrjes në qytetin e Peshkopisë dhe Lumturie Koka ekserte pranë Bashkisë Mat në qytetin e Burrelit.

Unë jam Denis Lushi trajner dhe këshillues CEFE për sipërmarrjen dhe biznesin, me profil ekspert i zhvillimit rural. Aktualisht jam drejtues i organizatës Klubi i Sipërmarrësve të Rinj në Peshkopi si dhe administroj një biznes start-up në fushën e riciklimit. Jam angazhuar për një kohë të gjatë me çështjet e qeverisjes vendore në projekte të zbatuar nga UNDP Shqipëri, çështjet e zhvillimit rural, të drejtat e të rinjve dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje, ngritjen e kapaciteteve të të rinjve dhe grave rurale në aftësitë sipërmarrëse, trajnime dhe këshillime për krijimin e start-up-eve etj, hartimi dhe zbatimi i planeve të biznesit, trainimi dhe mentorimi për sipërmarrësit dhe nevojat e biznesit etj. Gjithashtu jam i angazhuar si ekspert rinor lokal në grupin e punës në iniciativën e Laboratorit Rinor të Ballkanit Perëndimor, për hartimin e "Udhërrëfyesit Kombëtar për Tranzicionin e të Rinjve nga Shkolla në Vendin e Punës", një projekt rajonal me fokus tek punësimi rinor implementuar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC) me mbështetjen e Bashkimit Evropian (EU).

Denis Lushi- trajner, këshillues CEFE për sipërmarrjen dhe biznesin.

Me Albanian Skills bashkëpunimi i parë ka qenë në vitin 2019 gjatë një trajnimi për aftësitë e buta dhe dixhitale për të rinjtë të zhvilluar në Peshkopi, një projekt i zbatuar nga Albanian Skills dhe Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD). Falë kësaj eksperience pozitive kontaktet e mia me Albanian Skills ishin të shpeshta. Për dy vite rresht jam angazhuar vullnetarisht si mentor dhe anëtar jurie për grupet e të rinjve konkurrues me ide biznesi për start-up në edicionet e vitit 2020 dhe 2021 të Konkursit të Aftësive Shqiptare organizuar nga Albanian Skills. Së fundmi u përzgjodha si koordinator lokal për Bashkinë Dibër në projektin "Një hap larg nga karriera juaj" Korrik 2021 – Shkurt 2022, implementuar në Bashkitë Dibër, Mat dhe Kukës, projekt i zbatuar nga Albanian Skills financuar nga Programi i Ambasadës Amerikane për Demokraci. Një nga produktet e projektit ishte ofrimi i shërbimit të Zyrës së për Informim dhe Këshillim Karriere në tre bashkitë partnere, shërbim që tashmë është funksional dhe sot. Një aktivitet tepër pozitiv i projektit ishte dhe organizimi i Akademisë së Karrierës në Tetor 2021 për të rinjtë e tre bashkive, ku në fokus ishte prezantimi i të rinjve me koncepte të reja, dije dhe ide që sot janë të rëndësishme për të fituar dhe zhvilluar aftësitë e nevojshme në jetën profesionale dhe personale.

©AlbanianSkills

Tashmë po bëhen rreth 12 vite që jam i angazhuar drejtpërdrejtë në punën me të rinjtë për fuqizimin e tyre profesional dhe personal, sidomos në Bashkinë Dibër. Të rinjtë kanë kapacite, janë energjikë dhe inovator por akoma nuk kanë suportin e duhur dhe u mungon informacioni për të orientuar veten dhe të përshtaten me tregun e punës. Nuk mjafton vetëm arsimimi që të rinjtë të gjejnë suksesin e tyre qoftë ky arsimim i përgjithshëm apo profesional. Të mos harrojmë që fatkeqësisht kemi edhe të rinj që nuk kanë as arsimimin bazë. Nevojitet edukimi dhe aftësimi gjatë gjithë jetës jo vetëm për aftësitë profesionale por edhe për aftësitë e buta që në fakt është një term i ri që po gjen zbatim edhe në Dibër. Nga puna ime me të rinjtë në Peshkopi dhe zonat rurale shoh dëshirën e të rinjve për të patur sukses në jetë, në karrierë, por shpesh ata janë të vetëm në këtë rrugëtim. Mbështetja e familjes nuk mjafton por nevojitet informacion dhe suport nga aktorë te tjerë, duke ditur që të rinjtë përballen me koncepte të reja për punën dhe punësimin. Për të rinjtë tradicionalisht punësim do të thoshte vetëm gjetja e një vendi pune në institucion shtetëror, në sektorin privat ose angazhim në ekonomitë e bizneseve familjare.

Por në këto 6 vitet e fundit po gjen zbatim koncepti i vetëpunësimit të të rinjve nëpërmjet sipërmarrjes ose hapjes së një biznesi të ri start-up. Për këtë shumë trajnime janë ofruar për të rinjtë pasi është një rrugëtim jo i lehtë dhe nevojiten aftësi të ndërthurura profesionale dhe të buta për nisjen e një sipërmarrje biznesi. Nga puna ime në organizimin e trajnimeve të tilla në projekte të ndryshme në Dibër për gati 3 vite deri më sot janë arritur të hapen nga të rinjtë 18 biznese start-up të lançesuar. Duke parë këtë numër të konsiderueshëm të të rinjve të futur në rrugën e sipërmarrjes nevojitet që programe të tilla të shtohen duke tentuar të përfshihen edhe të rinjtë që nuk kanë akses informacioni në këto iniciativa, sidomos të rinjtë nga shtresat e marxhinalizuara. Në mbyllje mund të thuhet që nevojitet një bashkëpunim më i mirë mes aktorëve dhe grupeve të interesit për të suportuar dhe fuqizuar të rinjtë dibranë.

Lumturie Koka
Njësia e Integrimit Evropian dhe Zyra për Informimin dhe Këshillim për Karrierën pranë Bashkisë Mat

I dashur lexues, është kënaqësi për mua që të shpreh mendimet e mia në këtë Buletin është një kënaqësi e mbi të gjitha për punën e përbashkët gjatë zbatimit të projektit ***"Një hap larg nga karriera juaj/ A visit far from future career"*** i financuar nga Programi i Ambasadës Amerikane për Demokraci. nga korriku 2021-shkurt 2022, dhe zbatuar nga Albanian Skills në bashkëpunim të ngushtë me Bashkitë e Kukësit, Matit dhe Dibrës.
Une jam Lumturie Koka, dhe prej 4 vitesh punoj tek Njësia e Integrimit Evropian pranë Bashkisë Mat, ku puna ime lidhet ngushtë me të rinjtë, angazhimin e tyre në aktivitete të shumta, fuqizimin e tyre përmes praktikave të ndryshme të cilat ndikojnë në zhvillimin e tyre profesional. Gjithashtu, prej disa muajsh po drejtoj edhe zyrën për informim dhe këshillim karriere të ngritur gjatë këtij projekti. Zyra e Informimit dhe Këshillimit të Karrierës synon të mbështesë në fuqizimin e të rinjve, vajzave dhe djemve me aftësitë e nevojshme për tregun e punës, promovimin e vetëpunësimit dhe ndërmarrësisë si dhe ndërgjegjësimin e biznesit për punësimin e të rinjve.

Zyra për Informimin dhe Këshillim për Karrierën e hapur në Bashkinë Mat dhe ofron shërbime karriere në mënyrë të vazhdueshme. Së bashku me ekipin e Albanian Skills mundëm të kishim një bashkëpunim tejet frytdhënës ku kemi realizuar trajnime të ndyshme për të rinjtë dhe një aktivitet përmbyllës ku të rinjtë nga të treja bashkitë vizituan zyrat e karrierës, të tr qytetet dhe u njohën më shumë me njëri tjetrin.

©AlbanianSkills

Gjithashtu zyra për Informim dhe Këshillim Karriere ka vazhduar dhe pas përfundimit të projektit me takime me të rinjtë ku janë trajtuar tematika të ndryshme si;

- Forcimi i lidhjes me biznese të ndryshme të qytetit, ku gjatë këtyre takimeve u informuan që tashmë zyra është hapur dhe funksionale.

-Vëzhgimet dhe plotësimi i vazhdueshëm i pyetësorëve ndihmon të rinjtë të përfshihen në orientimin dhe këshillimin për karrierën në mënyrë që ato të zbulojne drejtimet, profilet dhe profesionet që janë më të përshtashme për ta.

-Takimet me stafin e zyrës vendore të punësimit Mat, ku diskutuam në lidhje me organizimin e disa trajnime në lidhje me orientimin dhe informimin e të rinjve për praktikat, dhe kurset profesionale si dhe mënyën e aplikimit për punësim. Ju kemi ardhur në ndihmë qytetarëve në shkrimin e CV-is si dhe letrat e motivimit.

I dashur lexues vizioni i Zyrës për Informim dhe Këshillim Karriere është të krijojë një vend të sigurt ku të rinjtë të drejtohen dhe të marrin informacion të pakushtëzuar për zhvillimin e tyre profesional. Për më tepër, të krijohet një mjedis gjithëpërfshirës në të cilin të gjithë studentët, të rinjtë kanë qasje të barabartë në mundësitë për eksplorimin dhe përparimin e karrierës tani dhe gjatë gjithë jetës së tyre .

INTERVET WB
LËVIZSHMËRIA E NXËNËSVE PËR TË MËSUARIT

Miratuar në vitin 2019, projekti INTERVET WB do të lejojë 360 studentë nga të gjitha shkollat e AFP të 6 shteteve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi, Serbi, Maqedonia e Veriut dhe Bosnje) të kryejnë një praktikë 1 Mujore jashtë vendit dhe 56 nxënës me praktikë 3 Mujore.

Pas udhëtimeve në Maribor të Sllovenisë, Sevilja të Spanjës dhe Lyon të Francës, nxënësit e shkollës Teknike- Ekonomike Tiranë u vendosën në kompanitë përkatëse ku ndoqën praktikat për një ose tre muaj në fushën e IT, Turizmit, Gastronomisë, Elektronikës, Ndërtimit, Administrimit etj. Këto praktika ishin shumë të suksesshme për studentët, duke marrë vlerësime dhe reagime shumë pozitive nga kompanitë ku ata punonin. Më poshtë mund të lexoni disa nga dëshmitë e vetë studentëve të cilët ishim pjesëmarrës në mobilitete. Fillimisht do ta nisim me një dëshmi nga drejtoresha e shkollës Teknike- Ekonomike Tiranë Anila Nanaj (Bani).

Përshëndetje të gjithëve. Unë jam Anila Nanaj(Bani) Drejtore e shkollës Teknike Ekonomike Tiranë. Projekti Intevert ka qenë një projekt në të cilin kanë qenë pjesëmarrës dhe nxënës nga shkolla të cilën unë drejtoj. Njohja me projektin Intervet ka qenë nëpërmjet AKPA-ës (Agjensisë Kombëtare të Punësimit) dhe organizatës Albanian Skills. Pjesëmarrës nga shkolla Teknike Ekonomike kanë qenë nxënës të cilët ishin në praktika njëmujore dhe tremujore ne Itali dhe Spanjë. Praktikat në këto vende të Bashkimit Europian kanë qenë një eksperiencë mjaft e mirë dhe e vlefshme për nxënësit, por dhe për ne si institucion ofrues i arsimit profesional, pasi është një qasje e re dhe na ndihmon që të zhvillohemi më tej.



Praktikat e nxënësve janë ndjekur hap pas hapi nga mësuesit e shkollës në mënyrë që rezultati në fund për nxënësit të jetë sa më i kënaqshëm. Por kjo eksperiencë e nxënësve ka pasur dhe disa sfida të cilat jemi munduar që ti kalojmë sa më lehtë. Ndër këto sfida, mund të përmendim pasiguria e prindërve të nxënësve për të cilët ishte një eksperiencë e re dhe informacioni për këtë intership nuk është shumë i madh. Gjithashtu, angazhimi i nxënësve në mësimdhënien në distancë ishte një nga sfidat me të cilat ne si shkollë u hasëm dhe mësuesit në veçanti përballuan mësimdhënien dhe vleresimin e dijeve jo në mënyrën dhe kohën e planifikuar në fillim të vitit shkollor,por individualisht dhe me nje plan individual vleresimi.
Pavarësisht këtyre sfidave praktika pjesëmarrja në mobilitete ishte një eksperiencë të cilën çdo nxënës nuk duhet ta humbasë pasi është mjaft e vlefshme për të ardhmen e tij.

NE NUMRIN E ARDHSHEM

EAfA-Aleanca Evropiane e Praktikave Profesionale

Aleanca Evropiane për Praktikat (EAfA) bashkon qeveritë dhe aktorët kryesorë me synimin për të forcuar cilësinë, ofertën dhe imazhin e përgjithshëm të praktikave në të gjithë Evropën, duke promovuar gjithashtu lëvizshmërinë e praktikantëve. Këto synime promovohen përmes angazhimeve kombëtare dhe premtimeve vullnetare nga palët e interesuara. Albanian Skills- Shoqata Kombëtare për Konkurset e Aftësive është anëtare aktive që nga Nëntori 2018 dhe në publikimin e radhës do t'ju tregojë gjithçka rreth EAfA dhe përvojës sonë të madhe dhe të frytshme për ne.



EAfA - European Alliance for Apprenticeships

©AlbanianSkills

Përvoja e Kelvin Ziflës gjatë kursit të gjuhës angleze me nxënësit e përzgjedhur për lëvizshmërinë e të mësuarit në vendet e BE-së

Mobilitetet jashtë vendit të mundësuar nga projekti INTERVET WB janë një mundësi shumë e mirë për çdo të ri që ndjek një arsim profesional por jo vetëm. Nëpërmjet këtyre shkëmbimeve që realizohen nxënësit kanë mundësi që të prekin nga afër mjedise pune të vendeve të Bashkimit Europian, të njihen me kulturën e këtyre vendeve por dhe të rriten profesionalisht. Pjesëmarrja në intership ka disa faza të caktuara që nxënësit i kalojnë dhe një nga këto faza është dhe parapërgatitja e nxënësve në mënyrë që të përshtaten sa më mirë atje. Për këtë gjë nxënësit realizojnë dhe një kurs të gjuhës angleze në mënyrë që të praktikojnë dhe mësojnë më mirë këtë gjuhë. Profesori i anglishtes Kelvin Zifla nëpërmjet një artikulli na tregon përshtypjet e tij për këtë eksperiencë që ai ka kaluar me nxënësit.

Kelvin Zifla - Profesor i Anglishtes

Përshëndetje unë quhem Kelvin Zifla dhe jam pedagog dhe përkthyes i gjuhës angleze. Kontakti im i parë me Albanian Skills ishte gjatë kohës kur unë isha student dhe vullnetar në një nga konkurset e saj vjetore të aftësive. Që atëherë, nuk i humba kurrë kontaktet dhe i ndiqja rregullisht evenimentet dhe arritjet e tyre.

Pasi Albanian Skills filloi Projektin INTERVET WB më kontaktoi dhe më kërkoi nëse mund të zhvilloja kurse të gjuhës angleze për studentë të arsimit profesional që kishin fituar mundësinë për të ndjekur praktika pune ndërkombëtare në Evropë. Ndihesha i nderuar që u riktheva dhe që mund të kontribuoja në Albanian Skills përsëri dhe mjaft mirënjohës për mundësinë. Ka qenë një bashkëpunim i shkëlqyer dhe aktualisht jap mësim për raundin e pestë të studentëve që po praktikojnë gjuhën angleze për t'u përgatitur për praktikat e tyre të punës në Lion të Francës, Milano të Italisë dhe Sevilia të Spanjës!





Më duhet të them që ka qenë një përvojë emocionuese dhe frymëzuese! Ashtu siç u kam mësuar studentëve të arsimit profesional, kam mësuar edhe prej tyre, veçanërisht prej punës, kreativitetit, dhe mbi të gjitha risive të tyre! Shumë herë jam befasuar nga projektet e tyre dhe kam dëgjuar për robotë, aplikacione dhe biznese të nisura nga zeroja nga këta studentë 16-18-vjeçarë. Ata kanë një shkallë të lartë orientimi në karrierë, shpirti sipërmarrjeje dhe disipline pune që thjesht më ka bindur se këta të rinj do të arrijnë shumë në jetë. Në fakt, ata merrnin rregullisht vlerësime pozitive nga kompanitë e tyre të internshipit (në Itali, Spanjë, Poloni dhe Slloveni), çka vërteton cilësitë e tyre të panumërta.





Një eksperiencë mësimdhënëse që më ka mësuar shumë. Arsimi profesional në Shqipëri avancon çdo ditë dhe duket qartë që nxit sipërmarrjen dhe novacionin që në moshë të re, diçka e rrallë në Shqipëri. Këto talente të reja të frymëzojnë me admirim dhe respekt, dhe mezi po pres të dëgjoj për arritjet e tyre në të ardhmen e afërt!

©AlbanianSkills

DËSHMI TË NXËNËSVE PJESMARRËS NË MOBILITETE

Unë quhem Endrit Myrta dhe jam 19 vjeç, i sapodiplomuar në degën elektronikë (profili telekomunikacion) në shkollën teknike "Gjergj Canco".
Unë jam person që më pëlqen shumë të ndërveproj me njerëz, të mësoj prej tyre dhe të qëndroj gjithmonë i përditësuar me njoftimet që publikohen për aktivitete të ndryshme. I njëjtë ishte dhe rasti i thirrjes për praktika profesionale në Lion, në të cilën aplikova. Mezi prisja për përgjigjet e fituesve sepse kisha shumë dëshirë të merrja pjesë. Fatmirësisht u përzgjodha dhe isha jashtëzakonisht i lumtur që do isha pjesë e një përvoje të re, nëpërmjet së cilës do mësoja shumë në shumë aspekte.

Endrit Myrta Shkolla Teknike "Gjergj Canco" Tiranë

Ditën e nisjes për në Lion takova personat, me të cilët do qëndroja 1 muaj, por më vonë u bënë miqtë e mi. Pasi mbërritëm në Lion, u nisëm drejt rezidencës studentore, tek e cila do qëndronim të gjithë. Ishte hera e parë që jetoja vetëm, por me kalimin e kohës fillova të përshtatesha. Çdo gjë ishte në përgjegjësinë time dhe unë duhet të menaxhoja çdo gjë lidhur me akomodimin, mirëmbajtjen e dhomës, menaxhimin e kohës dhe të parave të xhepit dhe detyrave që më caktoheshin nga kompania ku po kryeja praktikën. Ditët kalonin dhe fillova të përshtatesha me këtë mënyrë të jetuari (nuk ishte aq e vështirë). Përveç kësaj, me pjesën tjetër të grupit filluam të njihnim karakteret e njëri-tjetrit, shkëmbenim përvojat dhe ngjarjet që kishim përjetuar në të shkuarën, bënim shaka, qeshnim, diskutonim për çështje të ndryshme dhe u miqësuam vërtet shumë.

Praktikën e zhvillova te kompania "Foxstream", veprimtaritë e së cilës janë të ngjashme me atë që kam studiuar dhe punuar në Shqipëri. Aty mësova dhe shumë gjëra të tjera në aspektin praktik, për të cilat jam shumë i sigurt që do më japin përfitime në të ardhmen dhe në karrierën time në fushat e inxhinierisë dhe shkencave. Krahas aftësive teknike, si mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve, unë gjithashtu përmirësova aftësi të tjera ndërpersonale, si komunikimi me persona të kulturave të ndryshme, komunikimi në gjuhë të huaj, bashkëpunimi me grupin, dëgjimi aktiv, arti i të debatuarit, etj.
A do më ndihmojnë këto aftësi mua? Sigurisht që po! Të gjitha këto aftësi, do më ndihmojnë të jem person më i dobishëm për shoqërinë dhe komunitetin, por dhe të jap kontributin tim, duke zbatuar pikërisht aftësitë e fituara, për të venitur sadopak problemet që kemi në Shqipëri.
Këtë përvojë nuk do e harroj kurrë. Jam kënaqur pafund, kam mësuar shumë, kam zgjeruar rrethin tim të miqve të ngushtë dhe mezi pres që të bashkëpunoj herët apo vonë, me të gjithë ose jo, në një mënyrë ose në një tjetër, pavarësisht rrethanave.
Jam përjetësisht mirënjohës dhe falënderues ndaj të gjithë institucioneve që e mundësuan këtë përvojë për ne!
Faleminderit që më lexuat!

©AlbanianSkills

Unë jam Regisa Sala 18 vjeç, nxënëse në Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë. Drejtimi që unë studioj është Ekonomi-Biznes në profilin Kontabilitet.
Mënyra se si unë u bëra pjesë e këtij intershipi ishte nëpërmjet nje njoftimi në rrjetet sociale të organizatës Albanian Skills ku në një postim jepej njoftimi për mundësinë e një praktike jashtë vendit për nxënësit e shkollave profesionale. Menjëherë me shumë dëshirë aplikove dhe fitova, u bëra pjëse e grupit të nxënësve që do të shkonin në Maribor të Sllovenisë. Isha pafund e lumtur dhe emocionuar në të njëjtën kohë.
Gjatë një muaji në Maribor unë fitova një eksperiencë të veçantë dhe mësova shumë. Praktika ime ishte në degën e Marketingut dhe Social Media. Të them të vërtetën jam e magjepsur se si vendi i punës, kolegët dhe njerezit që kam njohur përgjatë kësaj eskperience ishin aq fantastik dhe aq suportues. Kam mësuar aq shumë dhe kam zhvilluar njohuritë e mia në këtë degë duke i përmirësuar edhe më shumë ato. Maribori ishte një vend aq i qetë dhe paqësor saqë mezi pres ta vizitoj përsëri .
Dua që ta sugjeroj për këdo që sheh mundësi të tilla të aplikoj pa u menduar dy herë. Është ndër ato eksperienca që të ndihmon në zhvillim personal, të jesh e pavarur dhe të mendosh gjërat në pikëpamje tjetër.
Faleminderit për këtë mundësi të artë!



Regisa Sala Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë

Unë quhem Saimira Spiropali, jam 18 vjeç dhe studioj në degën Ekonomi-Biznes në shkollën Tregtare në qytetin e Vlorës dhe isha pjesë e intershipit njëmujor në Maribor të Sllovenisë. Për mua kjo ishtë një eksperiencë shumë e bukur dhe mjaft e vlefshme për karrierën time. Kam pasur mundësinë që të realizoj një praktikë profesionale shumë të mirë që më ka ndihmuar dhe se si ta prezantoj veten time shumë mirë nga ana profesionale në një mjedis pune. Jam takuar me njerëz të rinj nga vende të ndryshme si nga Spanja, Gjermania, Sllovenia etj, gjë që më ka bërë të mësoj sa më shumë rreth kulturës së tyre. Përgjatë kësaj eksperience kam vizituar dhe vende shumë të bukur si Mali Pohorje, Kodrën Poramida, Lubjanën, Liqenin Bled dhe Zagrebin.

Saimira Spiropali, Shkolla Tregtare Vlorë

©AlbanianSkills

Përshëndetje unë jam Ilaria Bogdani, nxënëse në shkollën Teknike Ekonomike Tiranë, dega Llogari & Kontabilitet. Të fitosh një internship në Lyon është një mundësi e artë. Ky udhëtim më mësoi jetesën vetëm, më bëri më të pavarur, të dija se si ti shpenzoja lekët e xhepit, të ambjentohesha me një vend të ri, të njihesha me miq etj. Përgjatë këtij Intershipi unë punoja tek kompania pritëse (SEPER) në departamentin internacional në fushën e marketingut. Kompania do të hapte një website dhe detyra jonë ishte që të kërkonim rreth shkollave te tjera profesionale të Lyonit, por edhe jashtë saj konkurrentët, të mbanim shënime, dhe pasi të analizonim të përbashkëtat dhe të veçantat do të ndërtonim nje tabelë në excel. Kolegët e punës ishin shumë të afrueshëm, mjedisi ku punoja ishte shumë miqësor, gjithashtu mësova shumë gjëra të reja. Gjatë kohës së lirë shkonim së bashku te vizitonim vënde të reja si: Bellecour,Sant Jean, Fourviere,Planetarium,Parc de la Te Dor, Traboule,Jardin du Rosaire, Teatro Galo Roman. Për mua ishte një eksperiencë fantastike.

Ilaria Bogdani, Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë

©AlbanianSkills

Eksperienca e shoqëruesve të Grupeve

Ashtu siç e kemi thënë projekti Intervet ka disa faza të caktuara, i tëri është një proces. Pjesë e këtij procesi me një rol shumë të rëndësishëm dhe sfidues me raste janë dhe shoqëruesit e grupeve. Entela dhe Klevisi kanë qenë shoqerues të grupeve të nxënësve dhe nëpërmjet artikujve ato do të na tregojnë më shumë për eksperiencën e tyre.

Klevis Musai

Përshëndetje unë jam Klevis Musai, 19 vjeç dhe sapo kam mbaruar gjimnazin në shkollën e mesme teknologjike"Hysen Cela", së fundmi kisha një detyrë tepër të bukur dhe sfiduese, atë të të qenurit shoqërues i grupit të nxënësve në Maribor të Sllovenisë. Gjatë muajit nëntor unë isha një prej nxënësve të përzgjedhur për të kryer praktikën njëmujore në Poloni, e cila ishte një eksperiencë e paharrueshme. Pasi kaluan disa muaj, mu dha mundësia për të qenë shoqëruesi i grupit në Slloveni. Të them të drejtën fillimisht u stepa, sepse duhet të udhëhiqja një grup studentësh të së njejtës moshë me mua, por pas disa ditësh dhashë dakordësinë time për ti shoqëruar dhe e them me plot bindje që ishte një ndër eksperincat më të bukura që unë kam kaluar. Ishte një muaj shumë intensiv dhe i shpejtë, i cili kaloi si një fundjavë. Në fillim mund të them që isha dhe i pasigurt nëse do të arrija ti menaxhoja të gjitha situatat që do të lindin, a do të mund të drejtoja dot një grup adoleshëntësh kur dhe vet isha një i tillë, por si të thuash të mëson puna vetë dhe ia del për mrekulli mjafto të kesh vullnet dhe dëshirën e mirë për t'i bërë gjërat. Brenda një periudhe të shkurtër pata mundësinë të mësoja shumë gjëra, të njihesha me një vend të ri, njerëz të rinj, të eksploroja por te të mësoja më shumë nga vetja ime. I jam shumë falendërues organizatorëve për mundësinë, ka qenë shumë domethënëse për mua.

©AlbanianSkills

Të isha shoqëruese e një grupit të parë të nxënësve realizuan mobilitetin në Itali qytetin e Bolognias dhe me grupin e nxënësve në Lyon të Francës ishte një ekperiencë e vlefshme dhe e bukur. Jetesa për një muaj me njerëz dhe kulturë të ndryshme ishte një sfidë më vete por dhe një periudhë e cila të rrit shumë si nga ana komunikuese, njerëzore por dhe nga ajo profesionale. Përgjatë muajit çdo ditë përballeshim me gjëra nga më të ndryshme si menaxhimi i kohës, orareve, eksplorimi i vendodhjeve, menaxhimi i grupit të të rinjve duke ruajtur balacat dhe duke qenë gjithmonë vigjilente për çdo situatë që mund të ndodhë. Këto sfida të zhvillojnë shumë pasi realiteti me të cilin përballesha çdo ditë është ndryshe me të cilin je mësuar aq më shumë që duhet të jesh gjatë gjithë kohës me një grup të rinjsh. Këto eksperienca do të mbeten gjatë në kujtesën time dhe do më ndihmojnë në profesionin që unë kam zgjedhur.

ENTELA GJYLA

©AlbanianSkills

NE NUMRIN E ARDHSHEM

Përvojat e nxënësve gjatë lëvizshmërisë për të mësuarit në Milano- Itali dhe Sevilia-Spanjë.

Pas mbylljes së thirrjes së pestë për praktikë njëmujore në kuadër të projektit INTERVET. Me këtë thirrje u përzgjodhën 20 nxënës nga të gjitha shkollat profesionale të Shqipërisë të cilët do të nisen në Shtator 2022 për një muaj në Itali dhe Spanjë .

Në numrin tjetër do të keni dëshmi të nxënësve për eksperiencë të cilën ato do të kalojnë. Ndjesitë pozitive, emocionete bukura, sfidat që kanë kaluar përgjatë kësaj eksperience. Por si dhe aktivitetet e realizuara, përshtatja në kompanitë pritëse dhe me vendin ku ato kanë jëtuar për rreth një muaj.



Përvojat e mësuesve gjatë Job Shadowing, Maltë

Pas mbylljes së thirrjes së ku u përzgjodhën 3 mësues mësues / staf nga të gjitha shkollat e AFP-së në Shqipëri, të cilët në Tetor 2022 do të shkojnë në Malta. Në numrin tjetër ne do të kemi dëshmi të mësuesve në lidhje me eksperiencën e tyre atje.

©AlbanianSkills

Studentët nga Italia --Përvojat e tyre gjatë qëndrimit dhe praktikave profesionale në Tiranë, Shqipëri, në kuadër të Erasmus+

Përgjatë muajve Shtator- Tetor 2022 Albanian Skills mirepriti 8 studentë nga Italia të cilët realizouan praktikat profesionale njëmujore pranë kompanive shqiptare.

"International Leather Line & Conf Expo 2022"

Më datë 15 Tetor 2022 pranë ambjenteve te Expocity Albania do të mbahet konkursi në fushen e tekstilit dhe lëkurës.

Ditët e Karrierës pranë Bashkive Mat; Dibër; Mirditë; Has.

Të shtunat e Nëntorit do të jenë të mbushura plot me aktivitete rinore pranë bashkive Mat; Dibër, Mirditë dhe Has.

Diskutime të bukura, frytdhënëse me të rinjtë pritet që të realizohen.

©AlbanianSkills